



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
Komisioni Institucional i Zgjedhjeve

Nr. 71 Prot.

Datë 17/05/2022

UDHËZIM

“Mbi

zhvillimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme, për drejtues të njësisë kryesore dhe anëtar të Senatit Akademik, në Fakultetin e Drejtësisë të UT-së”

Bazuar në nenin 6 të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës”, Kreu II, neni 6, pika 2, germa “a”, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve në UT,

UDHËZON:

1. Administratori i njësisë kryesore ku do të zhvillohet procesi zgjedhor, duhet të japë mbështetjen e duhur, për të siguruar mjediset ku do të ngrihen qendrat e votimit, si dhe për të krijuar kushtet për mbarëvajtjen e procesit të votimit.
2. Në mjediset përreth Qendrave të Votimit, është e ndaluar rreptësisht prania e materialeve të fushatës zgjedhore të kandidatëve garues.
3. KZF-ja dhe Administratori i Njësisë Kryesore, janë përgjegjës për garantimin e standardeve zgjedhore.
4. Në mjediset e njësisë kryesore, gjatë ditës së zgjedhjeve, është e ndaluar kategorikisht fushata në mbështetje të kandidatëve garues. Personeli i administrimit në njësinë kryesore, duhet të marrë masat e nevojshme, duke komunikuar me KZF-në e njësisë ku po zhvillohet procesi i votimit.
5. Qendra e votimit hapet në orën 8:00 dhe mbyllet zyrtarisht në orën 16.00. Nëse pas orës 16.00 ka ende votues në radhë, mblidhen mjetet e tyre të identifikimit dhe procesi përfundon pasi edhe këta të fundit, të kenë votuar.
6. Votuesit ndjekin sinjalistikën për t’u drejtuar në qendrën e tyre të votimit, respektojnë radhën jashtë qendrës së votimit, si dhe futen njëri pas tjetrit në qendrën e votimit për të votuar, me thirrjen nga një anëtar i komisionit të QV-së.

7. Në Qendrën e Votimit është i ndaluar kategorikisht përdorimi i celularit si nga votuesit ashtu edhe nga anëtarët e komisioneve zgjedhore, me përjashtim të Kryetarit të KZF-së apo anëtarit të ngarkuar nga Kryetari, si koordinator me KIZ-in.
8. Votuesit e trupës zgjedhore të kategorisë “student”, paraqiten para KQV-së duke u identifikuar; cilëson programin e studimit ku bën pjesë, si dhe paraqet para komisionit një nga dokumentet zyrtare të vlefshme të identitetit, si Kartë Identiteti, Pasaportë ose Kartë Studenti.
9. Kryetari i KQV-së, verifikon nëse të dhënat e identitetit të votuesit, përputhen me të dhënat në listën e zgjedhësve dhe nëse votuesi është i njëjtë me personin në dokumentin e identifikimit. Kryetari shënon në listën e zgjedhësve, llojin dhe numrin e serisë së dokumentit të identitetit dhe më pas i vendos vizë emrit të zgjedhësit në këtë listë.
10. Studenti, që është i pajisur nga një Vendim për të votuar, lëshuar nga KIZ-i, pasi hyn në QV, paraqet Vendimin tek kryetari i komisionit në atë Qendër Votimi. Emri i këtij zgjedhësi dhe numri i kartës së identitetit të tij shënohen në Fletoren e Protokollit të Ditës së Votimit, e cila më pas futet në Kutinë e Materialeve dhe Dokumenteve të Votimit, që dorëzohet në KIZ.
11. Votuesi nënshkruan në listën e zgjedhësve përbri emrit të tij.
12. Votuesit nga trupa zgjedhore në kategorinë “student” në Fakultetin e Drejtësisë të UT-së, i jepet për të votuar fleta e votimit:
 - i. për drejtues të njësisë kryesore
13. Votuesit nga trupa zgjedhore në kategorinë “personel akademik” në Fakultetin e Drejtësisë të UT-së, i jepet për të votuar fleta e votimit:
 - i. për drejtues të njësisë kryesore;
 - ii. për anëtar në Senatin Akademik të UT-së.
14. Çdo fletë votimi është e vulosur, në pjesën e pasme të saj, me vulën e KZF-së dhe KQV-së kur ka të tilla.
15. Pasi merr fletët e votimit, zgjedhësi hyn i vetëm në dhomën e fshehtë:
 - i. në fletën e votimit për drejtues të njësisë kryesore/anëtar të Senatis Akademik, shënon në krah të emrit të kandidatit shenjën "+" ose "x" ose "√".
 - ii. pasi bën shënimin e tij në fletën e votimit, ai i palos fletët në mënyrë që shenja të mos jetë e dukshme por duhet të jenë të dukshme vula/vulat e KZF-së dhe KQV-së (kur ka të tilla), del nga dhoma e fshehtë, e hedh fletën në kutinë përkatëse të votimit.
16. Votuesi është i detyruar të hyjë në dhomën e fshehtë për të votuar, përndryshe nuk lejohet të fusë fletët e votimit në kuti.
17. Në qendrën e votimit ndalohet kategorikisht përdorimi i aparateve celulare apo i mjeteve të tjera regjistruese. Kur votuesi hyn në dhomën e fshehtë, nuk duhet të ketë me vete çanta, mjete apo sende, qoftë edhe shkollore.
18. Në qendrën e votimit, gjatë procesit të votimit lejohen të qëndrojnë vetëm:
 - anëtarët dhe sekretari i KZF/anëtarët e KQV-së;
 - zgjedhësit që janë duke kryer procedurat e votimit deri në përfundim të tyre;
 - vëzhguesit e akredituar nga KIZ;
19. Në qendrën e votimit, gjatë procesit të numërimit të votave lejohen të qëndrojnë vetëm:
 - anëtarët dhe sekretari i KZF-së;
 - kandidatët garues;
 - vëzhguesit e akredituar nga KIZ-i.

20. Kryetari i KZF-së në rast të shkeljes së rregullit dhe qetësisë nga pjesëmarrësit e lejuar gjatë procesit të numërimit, ndërpret procesin e numërimit, bën mbledhjen urgjente të KZF-së dhe merr vendimin përkatës për personin që cenon respektimin e standardeve zgjedhore. Për vendimin komunikon me KIZ-in dhe ky i fundit komunikon me Administratorin e UT-së, për marrjen e masave për sigurinë dhe rendin në institucion.
21. Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

- | | |
|---------------------|-----------|
| 1. Edvin Lame | (Kryetar) |
| 2. Xhensila Kadi | (Anëtare) |
| 3. Alnida Koroshi | - // - |
| 4. Shaniko Allajbeu | - //- |
| 5. Arjan Tushaj | - //- |
| 6. Eljon Doçe | - //- |
| 7. Dhurata Saraçi | - //- |

